



Planuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	06.09.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5172/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.642/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 642/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ kundër organit të punësimit/Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si bazuar ankesa me numër A.nr.642/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi _____ ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe rivendosje.
- II. Shfuqizohet Vërtetja me shkrim e datës 22.06.2022 me numër protokoli:1497 e shqiptuar nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
- III. Obligohet Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën I dhe II të dispozitiv në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 21.07.2022 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vërejtjes me shkrim me numër protokoli:

1497 të datës 22.06.2022 të shqiptuar nga Zëvendës Sekretarit i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me pretendimet ankimore se vërejtja i është dhënë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dispozitat e nenit 4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe akti i kontestuar nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.07.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Zyra e Kryeministrit. Ndërsa Këshilli me datë 01.08.2022 ka pranua nga Zyra e Kryeministrit përgjigjen në kërkesë e cila në Këshill është protokolluar me numër: 4450/2022 se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 642/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; At Emërimi i datës 25.02.2014; Përshkrimi i detyrave të Punës; Vërejte e datës 22.06.2022, me numër protokoll 1497, e Z.V, Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; e- maili i datës 22.07.2022; Përgjigje në ankese e datës 01.08.2022, me numër protokoll 4450/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *pjesërisht e bazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2014 mbanë pozitën e punës "Drejtor i Zyrës së Administratës Qendrore" në Zyrën e Kryeministrit dhe i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së, ndërsa sipas përshkrimit të Qëllimit të vendit të punës që e mban ankuesi (*përshkrim i shkurtër i pozitës dhe të arrijë kjo pozitë*) përcaktohet: "*Udhëheqja, koordinimi, planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi si dhe sigurimi dhe zhvillimi i politikave të punësimit, aplikimit të ligjeve dhe sigurimin e shërbimeve në fushën e TI-së, gjuhësorit, transportit dhe logjistikës në tërësi, si dhe të ndihmojë zhvillimin e rishikimit funksional të administratës brenda Zyrës së kryeministrit ZKM-së*".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me datë 22.06.2022 i ka shqiptuar vërejtjen me shkrim ankuesit për shkak të mos kryerjes së detyrave të punës sa i përket çështjes së aklimatizimit në Kabinetin e KM-së, vonesës me pajisje të punës për stafin e ri që fillojnë punën nëpër zyre, gabimet e stafit të IT-së në hapjen e faqeve përkatëse gjatë leximit të Expozesë së Kryeministrit në Mbledhje të Qeverisë si dhe mos menaxhimi/kontrollimi i funksionimit të pajisjeve elektronike nëpër salla.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se masa e shqiptuar ndaj ankuesit me datë 22.06.2022 përmes shkresës me numër protokoll:1497 nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është nuk bërë në pajtueshmëri nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "*1.Masat*

disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”, si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: “1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit”, pasi që Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit nuk ka arritur të përcaktojë apo kualifikojë shkeljen e pretenduar të ankuesit siç përcaktohet me nenin 4 paragrafi 4 të së njëjtës rregullore, gjegjësisht i njëjti në vërejtjen e shqiptuar i është referuar në mënyrë të përgjithësuar nenit 46 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa dispozitat e ligjit të referuar kanë bërë ndarjen e shkeljeve të detyrave të punës, dhe mbi bazën e përcaktimit të natyrës së shkeljes së detyrave të punës, në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë rrjedh edhe kompetenca për shqiptimin e masës disiplinore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nën 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: “Procedura disiplinore përfshin procedurën administrative, që kryhet nga marrja në dijeni për një shkelje disiplinore, deri në marrjen e një mase disiplinore nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt apo Komisioni Disiplinor”, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë fillimisht është dashur të bëjë kualifikimin e shkeljes së pretenduar dhe pasi që të ketë bërë kualifikimin e shkeljes është dashur të veprime siç përcaktohet me nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me qëllim që palës t’i mundësohet të paraqes versionin e tij apo provat lidhur me shkeljen pretenduar në procedurë administrative siç përcaktohet në nenin 4 paragrafi 3 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: “Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.

Kolegji i këshillit, meqenëse ka konstatuar shkelje procedurale me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të ankuesit, në kuptim të nenit 52 paragraf 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” e ka shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimin Vërejtjen me shkrim e datës 22.06.2022 me numër protokoll:1497 e shqiptuar nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, pasi që shqiptimi i masës disiplinore është përcjelle me shkelje procedurale të përcaktuara me dispozitat e ligjit material.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit është përcjelle më lëshime procedurale të përcaktuara në dispozitat e aplikuara të ligjit material që rregullojnë çështjen e përcaktimit dhe kualifikimit të shkeljeve të detyrave të punës, sikurse edhe kompetencën për shqiptimin e masave disiplinore pas fillimit dhe përfundimit të procedurës administrative, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është aprovuar pjesërisht vetëm për arsyet e dhëna si më lartë, ndërsa lënda i kthehet për ri-shqyrtim dhe ri-vendosje udhëheqësit të drejtpërdrejtë, gjegjësisht Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm i Zyrës së



Kryeministrit, ndërsa i njëjti me rastin e ri-shqyrtimit të lëndës së ankuesit Shkelzen Ibrahimimi duhet të eliminojë shkeljet e gjetura te evidentuara si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa kualifikimi i shkeljes së pretenduar, zhvillimi i procedurë administrative dhe eventualisht shqiptimi i masës disiplinore duhet të bëhen në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrat Publike dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 642/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së